

Platforma historike siameze [DigiSAL](#) prej kohësh është kthyer në ekranin zbavitës të të gjithë shqipëtarëve.



Mëngjeset, drekat, pasditet dhe darkat janë kurdoherë të mbushura me informacione virtuale në kohë reale, numra magjie me statistikat, reality-show 24 orë non-stop mbi jetën e kryeministrit Berisha dhe qeverisë së tij dhe një pasqyrim modest i arritjeve të jashtëzakonshme të reformave të kërkuara nga KE.

Por [DigiSAL](#) nuk ndalet me kaq.

Inxhinierët e qeverisë kanë shumë kohë që po punojnë në Laboratorin e Qeverisë për një projekt ambicioz nën iniciativën dhe kujdesin personal të [fizikantit Salbert Salshtajn](#), botuesi i [librit "Teoria e Liberalizimit dhe Futjakotitetit"](#)

[Dr.Salshtajn](#) i ka kushtuar jetën kërkimeve dhe eksperimenteve me Shqipërinë.

Nga transmetimi analog, DigiSAL do të nisë të shfaqë realitetin e mrekullueshëm të arritjeve të qeverisë në formatin bashkohor SD (Sal Definejshën).

Me Sal Definejshën, televizori juaj kthehet në një ekran magjik ku do shihen lajme vetëm me shifra stratosferike të rritjes bum-bum të ekonomisë, ku fjalët “mjerim, ushqime me listë, papunësi” automatikisht konvertohen me “bollëk, parajsë”, rrugë Kombi, trena elektrikë.

Së shpejti në [DigiSAL](#) do të nisin transmetimet e dokumentarëve që nga demonstratat fyt më fyt të pedagogut Berisha me forcat e diktaturës së kuçe në 1985, tek Çeku i Bardhë i viteve '90, misteret e ndërtimit të Piramidave, zënkat e rrepistave në Hip-Hip Trazira '97 dhe deri tek poligoni nuklear i Gërdecit, [zhvillimi i turizmin në zonat e nënShkodrës](#), anëtarësimi në NATO, Shqipëria 1 Euro, liberalizimi i vizave, e sa e sa të tjera. SD bën të mundur që edhe kronikat e zeza të shihen si kronika blu.



